



Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University			
Data e aplikimit: 04.11.2024			
Kodi i aplikimit: 057		2594	



**Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Anëtarësime e Universitetit Publik  
"Kadri Zeka", Gjiilan,**

**shpall këtë:**

**Thirrje për aplikime për shkëmbim studentor/semestral  
në Universitetin "Celal Bayar", Manisa - Turqi**

Universiteti Publik "Kadri Zeka", është pjesë e projektit KA107 ICM, 2022-2023, Erasmus+, në partneritet me Universitetin e Manisat "Celal Bayar" University në Turqi.

Programi Erasmus + KA107 ose shkëmbimi afatshkurtër dhe afatgjatë i studentëve (ICM) është një program i mobilitetit plotësisht i financuar nga projekti që mundëson shkëmbimin e studentëve, stafit mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës midis Universitetit të "Celal Bayar" University në Manisa nga Turqia dhe Universitetit Publik "Kadri Zeka", Gjiilan.

ICM Erasmus + mundëson shkëmbimin e studentëve nga Universiteti "Kadri Zeka" – Gjiilan për studim dhe trajnim / veprimtari të lëvizjes në fusha të ndryshme, studentëve u mundësohet që një semestër ta përfundojnë në Universitetin e "Celal Bayar" në Manisa nga Turqia.

Mundësi aplikimi kanë studentët nga Fakultetet:

Fakulteti i Edukimit;  
Fakulteti Shkencave Kompjuterike;  
Fakulteti Ekonomik;  
Fakulteti Juridik;

Për të gjitha fakultetet vlenë thirrja për nivelin Bachelor si dhe për nivelin Master.

**Në këtë thirrje do të pranohet një(1) studentë. Mobiliteti semestral duhet të realizohet gjatë semestrit të pranverës, viti akademik 2024-2025, (Mobiliteti zgjat 90 ditë);**

Të gjitha shpenzimet janë të mbuluar nga projekti në Universitetin pritës.  
800 Euro për çdo muaj si dhe 275 Euro për udhëtim të llogaritur sipas "Distance Calculator" të Erasmus+.



#### Shënim:

- 1) Të gjithë pjesëmarrësit duhet t'i përmbahen kufizimeve të alokuara buxhetore pasi që nuk ka fonde shtesë.
- 2) Buxheti i udhëtimit llogaritet sipas llogaritësit të udhëtimit dhe edhe nëse tarifa e biletës tejkalon shumën e mbështetjes së udhëtimit, nuk mund të jepen fonde shtesë për pjesëmarrësit.

#### Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Certifikata e notave;
- CV (në gjuhën angleze);
- Një letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim studenti (i lëshuar nga fakulteti juaj që konfirmon nivelin tuaj dhe vitin e studimit gjatë këtij viti akademik, jo më të vjetër se 30 ditë);
- Kopje e pasaportës (faqja që përmban emrin tuaj, fotografinë dhe të dhënat personale) ose Letërnjoftimit;
- Certifikata e gjuhës angleze ose gjuhës Turke; - (Për programet e ofruara në gjuhën angleze apo gjuhën turke, kërkohet niveli i gjuhës minimumi B2.)

Programet e ofruara në këtë mobilitet do të ofrohen në gjuhën angleze dhe si rrjedhojë kërkohet njohja e gjuhës angleze.

- 1). Studenti duhet të ketë të përfunduar të paktën 2 semestra në programin në të cilin janë regjistruar. Deri në ditën e fundit për aplikim, studentët të cilët kanë notë mesatare mbi 8.00 llogaritet si përparësi në aplikim.
- 2). Që studentët të marrin një grant të ICM-se, ata duhet të kalojnë të paktën një semester (3 muaj) në universitetin pritës. Granti i mobilitetit të studenteve të ICM mbulon minimumi 90 dite.
- 3). Studentët që do të marrin pjesë në programet e mobilitetit janë të obliguar të përfundojnë lëndë nga universiteti pritës në vlerën e ECTS-ve të kërkuara (rreth 5 kurse).

#### Vlerësimi i aplikantëve:

- Mesatarja e notës: 50%
- Gjuhë e huaj: 50%



## PROCEDURA E APLIKIMIT

- Aplikimet duhet të dorëzohen në Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Anëtarësime (kopje fizike), në mes të datave 04.11.2024 deri 16.11.2024.

Aplikimet e vonuara nuk do të pranohen.

- Rezultatet e aplikimit do të shpallen në [www.uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net)

Për çdo informatë shtesë, kontaktoni zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar dhe anëtarësime në UKZ.

Me respekt,

**Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka**  
Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte